# DËSHMI ARKIVI

**A-446268**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon Rama: Kryeqyteti prej thuajse dy vitesh jeton me “kokë të prerë”! Kalvar unik në historinë e Europës demokratike |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/15/vendimi-i-gjykates-se-larte-per-veliajn-reagon-rama-kryeqyteti-prej-thuajse-dy-vitesh-jeton-me-koke-te-prere-kalvar-unik-ne-historine-e-europes-demokratike/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 13:56:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 13:41:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `610c00763eda249375a8e7370b199c81d371b628a03f89a3d6837cbd2d475618` |
| TEKSTI | `369cf21d8a83d257a93aa441e74dfe678c2df927ed0b572020040ab6e6c46dbe` |
| PAMJA | `51afb2a13ab765060535db5a2ec2b39fa7fe8f61f213d80ddb6fda322947fb89` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `03f6b3d72776265b1b44832bc975888749d85dd23634dca1c03af545fec0de2d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/03f6b3d72776265b1b44832bc975888749d85dd23634dca1c03af545fec0de2d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon Rama: Kryeqyteti prej thuajse dy vitesh jeton me “kokë të prerë”! Kalvar unik në historinë e Europës demokratike

**Aktualitet**

Publikuar: 15/09/2026



Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të lënë në fuqi masën e sigurisë “arrest në burg” ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj. Rama thotë se Tirana mbetet sërish pa drejtuesin e zgjedhur, ndërsa e cilëson rastin e Veliajt një “kalvar unik në historinë e Europës demokratike” dhe ngre pikëpyetje për mungesën, sipas tij, të një prove që të justifikojë mbajtjen e tij në qeli.

**Rama:** *Përsëri Tirana pa kokë dhe përsëri kryetari i zgjedhur e i pagëzuar rishtaz nga vetë Kushtetuesja si i vetmi në detyrë dhe i palëvizshëm nga detyra, nuk mund të lëvizë nga qelia ku mbahet pa gjyq!*

*Po, rregulli e do që vendimet e gjykatave të respektohen dhe unë i nështrohem gjithnjë këtij rregulli – madje as nuk i komentoj vendimet përpara formës së prerë.*

*Por, përtej faktit që kalvari i Erion Veliajt është unikal në historinë e Europës demokratike dhe gjithashtu faktit që ende nuk shihet gjëkundi prova e rrezikshmërisë ekstreme, e cila mund të arsyetojë kyçjen e pambarimtë në qeli të një të zgjedhuri nga populli, ka një të vërtetë tjetër të hidhur:*

*Askush s’po do t’ia dijë për koston përditë e më të lartë të të parit kryeqytet në botë, që prej thuajse dy vjetësh jeton me kokë të prerë dhe për haraçin që thuajse 1 milionë banorë duhet t’i paguajnë përditë këtij eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik.*

TAG: Reagon rama | Veliaj | Vendimi i gjykatës së lartë

## Me te lexuarat


Bosi i Lufrës hap kartel kompanish dhe fondacionesh. A po pastron në ndërtim paratë e mashtrimit...


“AMG Food” e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë


Një burrë blinte të njëjtin buzëkuq çdo të premte: Punonjësja u përlot kur mësoi historinë


Greqia i kërkon Parlamentit Europian heqjen e imunitetit të deputetit socialist të PASOK-ut, Nikos...


Lufta e egër e Berishës ndaj Azem Hajdarit nga përgjimi, shantazhi, përjashtimi nga PD tek ndëshk...

## Të ngjashme



**Pagat e magjistratëve, thirren në komision institucionet e drejtësisë! KLP-GJL kundër formulës së PS, i bashkohet PD**



**Erion Veliaj mbeti në burg, reagon avokati mbrojtës: Vendimi ngre pikëpyetje për garancitë kushtetuese**



**Cënuan perimetrin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë**

# Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

# Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

# Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.